

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
Nr. No. br. 06-14486/2020
Data-Data-Datum 29.06.2020
Klinë-Klina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Klinës
Opština Klina – Municipality of Klina



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2021-2023 E KOMUNËS SË KLINËS

Klinë , Qershor 2020

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2021-2023

III. Korniza Fiskale

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2021-2023
- 3.3 Plani Komunal i financimit Sektorial me Ministritë e Linjës dhe Donatorë
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2021 -2023
- 3.6. Analiza Gjimore

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve

V. Informacionet sipas programeve

I. Hyrje

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2021-2023 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentat strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.


Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivave prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: granteve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2021/01 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

KAB 2021-2023 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2021.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2021-2023 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Klinës gjendet në pjesën veri – perendimore të Kosovës, rajoni i Pejës . Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Klinës ka gjithsej 54 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Klinës ka rreth 38496 banorë të organizuar në 5843 ekonomi familjare .

Mbi 1124 biznese operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Buxhet e financa , rreth 520 merren me veprimtari tregtare, 200 sherbyese , 204 prodhuese dhe 200 ndërtimore .

Administrata e Komunës së Klinës është e organizuar për rreth zyrës qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 9 të tilla në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Klinës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike,

që ka zhvilluar komuna siç janë: Strategjia e Zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2017-2021 , në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2021/01 të lëshuara nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Vizion i komunës është që Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, me një administratë komunale efektive në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Duke patur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike , prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve, bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës fizike. Të kemi ngritje dhe përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit dhe llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dytributeve , prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën, si :

1. Zhvillimi ekonomik

Përmes objektivave :

- Ndërmarrësia – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ;
- Zhvillimi i bujqësisë - mbështetje e sektorit bujqësor dhe blegtoral
- Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve

Përmes objektivave :

- Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese (reduktimi i procedurave)
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra
- Zgjerimi i infrastrukturës rrugore

3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë

Përmes objektivave :

- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore
- Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe AM

4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Përmes objektivave :

- Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës
- Ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit, tokës .

5. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Mirëmbajtjes së zyreve komunale (të gjendjes civile) dhe furnizimi me material të nevojshëm më qëllim të ofrimit të shërbimeve

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale . Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës. Komponentet e politikës makroekonomike siç janë bruto produkti vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2021 – 2023.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulët .

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Qeveritare**. Komuna është pranuese e **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe ka mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2021-2023 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë.

3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2020-2022

Të hyrat e Komunës së Klinës nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 1: Financimi komunal për vitet 2020-2023 sipas burimit

Korniza afatmesme buxhetore 2021--2023	Buxheti aktual 2020	Planifikimi 2021	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2023
Granti i përgjithshëm	4,203,809.00	4,080,410.00	4,327,637.00	4,597,435.00
Granti i arsimit	4,595,094.00	4,489,494.00	4,902,818.00	4,923,720.00
Granti i shëndetësisë	1,340,163.00	1,426,360.00	1,999,168.00	2,009,164.00
Të hyrat vetanake	915,074.00	915,074.00	1,075,090.00	1,112,821.00
Totali :	11,054,140.00	10,911,338.00	12,304,713.00	12,643,140.00




Figura 1: Buxheti total i komunës në vite

Siq shihet nga tabela më lartë , financimi për Komunën e Klinës në total nga viti në vit shënon rritje . Grantet për Komunën e Klinës për periudhën 2021-2023 si tërësi do të shenojnë rritje rreth 4.74% (- 1.29 + 12.77 + 2.75/3).

Të dhënat e prezantuara në tabelën më lartë bazohen në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2021-2023. Për vitin 2021 Granti i përgjithshëm dhe Granti i arsimit kanë rënje ndërsa Granti i shëndetësisë ka një rritje të lehtë .Rritje e lehtë është reflektuar në Grantin e përgjithshëm , në Grantin për arsim dhe në Grantin për shëndetësi në vitin 2022 dhe 2023 .

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale si burim i financimit komunal, në anën tjetër , për vitin 2021 nuk ka rritje as rënje , për vitin 2022 ka shënuar rritje për rreth 17.4% dhe në vitin 2023 rritje për 3.5% . Planifikimi i të hyrave nga gjykatat dhe dënimet në trafik do të planifikohen në nivelin qendror në institucionet të cilat i realizojnë këto të hyra .

Tabela 2. Të hyrat vetanake për 2020-2023

	2020	2021	2022	2023
THV	915,074.00	915,074.00	1,075,090.00	1,112,821.00




Figura 2: Buxheti nga të hyrat vetanake në vite

Tabela 3. Planifikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas burimeve për periudhën 2021-2023, në euro

Kodet	BURIMET E TË HYRAVE	Planifikimi - për vitin 2021	Planifikimi - për vitin 2022	Planifikimi - për vitin 2023
1)	Drejtoria e Urbanizmit	52,000.00	73,769.00	73,800.00
50009	Lejet për ndërtim	52,000.00	73,769.00	73,800.00
3)	Drejtoria e Inspektionit	6,000.00	6,050.00	6,080.00
50104	Denimet mandatore	2,000.00	2,000.00	2,000.00
50205	Komisioni inspektues	4,000.00	4,050.00	4,080.00
5)	Kadastra	78,000.00	78,500.00	78,500.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	78,000.00	78,500.00	78,500.00
6)	Administrata e përgjithshme	75,000.00	75,510.00	75,690.00
50013	Çertifikatat e lindjës	25,000.00	25,170.00	25,200.00
50014	Çertifikatat e kunorzimit	9,000.00	9,060.00	9,100.00
50015	Çertifikatat e vdekjës	1,000.00	1,000.00	1,000.00
50016	Çertifikatat tjera	25,000.00	25,170.00	25,200.00
50017	Të hyrat tjera	6,000.00	6,050.00	6,090.00
50019	Taksat administrative	9,000.00	9,060.00	9,100.00
7)	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	620,474.00	757,301.00	795,251.00
50217	Licencat	87,000.00	87,600.00	87,000.00
50001	Taksa për rexhistrimin e automjeteve	70,000.00	70,500.00	70,980.00
50407	Qiraja për lokalet afariste	9,000.00	9,060.00	9,100.00
50408	Qiraja për banesa	8,000.00	8,250.00	8,500.00
50403	Shitja e pasurisë	6,739.00	6,780.00	6,780.00
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	3,000.00	3,020.00	3,020.00
50406	Qiraja për treg të hapur	7,000.00	7,050.00	7,100.00
40110	Tatimi mbi pronën	352,114.00	427,733.00	427,733.00
	Tatimi në tokë	77,621.00	137,308.00	175,038.00
I	Totali i administratës komunale	831,474.00	991,130.00	1,029,321.00
	Të ardhurat nga arsimi			
50409	Qerdhet	24,000.00	24,160.00	24,200.00
50409	Arsimi fillor			
50409	Arsimi i mesëm	30,000.00	30,200.00	30,300.00
II	Totali - arsimi	54,000.00	54,360.00	54,500.00
	Të ardhurat nga shendetësia			
50409	Shendetësia primare	29,600.00	29,600.00	29,000.00
III	Totali - shendetësia	29,600.00	29,600.00	29,000.00
	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I + II + III)	915,074.00	1,075,090.00	1,112,821.00

Në këto projeksione janë marr parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme (tatimi në tokë dhe tatimi në pronë) sipas faturimit të tatimit në pronë dhe trendit të realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tri viteve të fundit, duke përfshirë nga këto projeksione të hyrat nga gjërat në trafik dhe të hyrat nga gjykatat.

Komuna e Klinës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 91.36 % të buxhetit total të komunës.

3.3 Plani Komunal i financimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Donatorët

Vlera totale e projekteve me Ministrinë e Linjës dhe Donatorë gjatë vitit 2021-2023 është 5,580,000.00 €.

Tabela 4: Projektet me financim nga Ministrinë e linjës dhe donatorët

Emertimi i projektit	Financuesi	Gjithsej euro:	Prokurimi nga	Komente	Opsionale	
					% për. meshk.	% përf. femra
Asfaltimi i rrugëve lokale në Klinë	MI	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i shtëpisë së pavarësisë në Bokshiq	MKRS	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Rregullimi i shtratit të lumit Drini i bardhë	MAPH	300,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Rregullimi i shtratit të lumit Klina	MAPH	150,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i liqenit akumulues për ujë të pijës	MAPH	500,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Pastrimi i shprekëve të lumenjve	MAPH	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Furnizim me kontejner për mbeturina	MAPH	20,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Implanti për ujë të zeza në Shtaricë	MAPH	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Implanti për ujë të zeza në Volljakë	MAPH	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i kanalizimeve në lagje të Klinës	MAPH	300,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i ujësjellësit në lagje të Klinës	MAPH	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i aneksit të shkollës "Motrat Qiriazl"	MASHT	350,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Përmirësimi i infrastrukturës së objekteve shkollore	MASHT	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në shkollat e Klinës	MASHT	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49

Blerja e dy autoambulantave	MSH	80,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Renovimi i QMF-ve	MSH	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i AMF-së në Perqevë	MSH	40,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i AMF-së në Këpuz	MSH	40,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i qendrës rinore - faza e dytë	MKRS	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i fushave të hapura sportive	MKRS	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i fushës së tenisit në Klinë	MKRS	50,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i sallës së sportit në shk. "Fehmi Agani "	MKRS	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Furnizimi me pajisje për shfaqjen e filmave	MKRS	30,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Zgjerimi i tribunave të stadiumit të qytetit-Klinë	MKRS	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i kendit të lojrave në Klinë	MKRS	50,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Asfaltimi i rrugës Jashanicë - Aqarevë	MI	350,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Projekte për komunitete	M. për kthim	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	MB	200,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Pyllëzimi i sipërfaqeve të xhveshura	MB	70,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i qendrës për të moshuar	MPMS	300,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i shtëpive për raste sociale	MPMS	100,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Ndërtimi i infrastrukturës së zonës ekonomike	MZHE	500,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Projekte të bashkëpunimit ndërkomunal	MAPL	250,000.00	Komuna	Planifikuar ende në diskutim	51	49
Totali :		5,580,000.000				

- Huamarrja

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2021-2023 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë

3.4 Politikat e reja

Komuna e Klinës në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2021-2023, sygjerimet e Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10 %) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2021 - 2023 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Klinës kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Në periudhen afatmesme Qeveria e Kosovës me formulën shtetërore për ndarje të grantit të arsimit për komuna, ndarje kjo që është bërë në qarkoren buxhetore 2021/01 në bazë të numrit të nxënësve, e që çdo vit bie numri i nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e komunës (ulë grantin e arsimit) duke pasqyruar se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal.

Komuna e Klinës do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për paga në sektorin publik, ndonëse ende nuk është bërë një analizë në lidhje me ndikimin në buxhetin e komunës. Kjo është për arsye se siç jeni të informuar kohë më parë në Kuvendin e Kosovës është miratuar Ligji i Pagave, mirëpo aktet nën-ligjore ende nuk janë miratuar, në këtë drejtim Komisionet përkatëse janë duke punuar në përcaktimin e koeficienteve për të gjitha pozitat.

Sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Klinës, është edhe politika në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Klinës aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga ministria e shëndetësisë dhe Ministria e Financave dhe transferove sa i përket këtyre politikave.

Komuna e Klinës ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qendrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2021-2023

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkorës Buxhetore komunale 2021/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2021, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Klinës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Tabela 6. Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2020 (buxheti aktual)	2021 (planifikim)	2022 (vlerësimet)	2023 (vlerësimet)
HYRAT TOTALE KOMUNALE	11,054,140.00	10,911,338.00	12,304,713.00	12,643,140.00
1.1 Të hyrat vetanake	915,074.00	915,074.00	1,075,090.00	1,112,821.00
1.2 Grantet dhe transferet qeveritare	10,139,066.00	9,996,265.00	11,229,623.00	11,530,319.00
SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	11,054,140.00	10,911,338.00	12,304,713.00	12,643,140.00
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	7,559,634.00	8,169,860.00	8,683,277.00	8,922,190.00
Pagat dhe medijtjet	6,058,700.00	6,673,860.00	7,093,983.00	7,288,935.00
Mallrat dhe shërbim	1,120,934.00	1,111,000.00	1,172,430.00	1,204,935.00
Shërbime komunale	180,000.00	180,000.00	198,010.00	203,452.00
Subvencionet	200,000.00	205,000.00	218,854.00	224,868.00
2.2 Rezervat	831,657.00	-	-	-
2.3 Shpenzimet Kapitale	2,662,849.00	2,741,478.00	3,621,436.00	3,720,950.00




Figura 3: Shpenzimet komunale të planifikuara sipas kategorive ekonomike për 2021

3.5.1 Pagat dhe Meditjet – kjo kategori e shpenzimeve në periudhen afatmesme pritet të rritet me një mesatare prej 6.39% . Rritja më e lartë parashihet në vitin 2021 rreth 10.15% pasi pritet aplikimit i Ligjit për paga . Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale në vitin 2021 pritet të mbetet në nivel të përafërt rreth 61 % e buxhetit .

3.5.2 Mallrat dhe Shërbimet -kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në periudhen 2021-2023 do të shënoj rritje për rreth 2.47 % . Në vitin 2021 pritet renje e lehtë prej 0.89% krahasuar me vitin 2020 ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 pritet rritje e lehtë nga viti në vit .Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2021 pritet të jetë rreth 10.18 %.

3.5.3 Shpenzimet komunale - kategoria e shpenzimeve komunale në periudhen 2021-2023 do të shenoj rritje prej 4.26% . N vitin 2021 pritet të ken pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2020 , ndërsa për vitin 2022 dhe 2023 pritet rritje për rreth 6.39 % . Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2021 pritet të jetë rreth 1.65 %.

3.5.4 Subvencionet – kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar 2021-2023 pritet të shënoj rritje prej rreth 4 % . Rritje më e lartë parashihet në vitin 2022, rreth 6.76 % për shkak të riklasifikimit të disa shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve kapitale në këtë kategori . Pjesëmarrja e transfereve dhe subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2021 pritet të jet rreth 1.88 % . Në vitin 2021 subvencionet do të shpenzohen për shëndetësi (ndihmë për shërimet bazuar në kërkesat e deponuara),kulturë,rini e sport , arsim,bursa per student, bujqësi) etj .

3.5.5 Investimet Kapitale - kjo kategori e shpenzimeve në periudhen 2021-2023 do të shënojë rritje mesatare prej rreth 12.6% . Në vitin 2021 pritet rritje prej 2.95% krahasuar me vitin 2020 . Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja e investimeve kapitale, nga buxheti i komunës do të bëhet nga viti në vit . Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2021 pritet të jetë rreth 25.13 %.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2020, planifikimi për vitin e ardhshëm 2021 si dhe vlerësimet për vitet 2022 dhe 2023.

Tabela 7: Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti aktual 2020

Programet	2020						
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Rezervat	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	88,482.00	35,000.00		120,000.00		18,430.00	261,912.00
Zyra e Kuvendit Komunal	93,872.00	5,000.00				46,804.00	145,676.00
Administrata dhe Personeli	223,868.00	87,000.00			85,000.00	48,921.00	444,789.00
Inspektimet	42,591.00	12,000.00			30,000.00	13,653.00	98,244.00
Buxheti dhe financat	120,431.00	125,934.00	80,000.00		60,000.00	39,948.00	426,313.00
Infrastruktura Publike	16,170.00	155,000.00			177,000.00	4,992.00	353,162.00
Ujarrfikësit dhe Inspektimet	124,928	20,000.00	5,000.00			9,293.00	159,221.00
Zyra Komunale për Komunitete	20,666.00	13,000.00				7,203.00	40,869.00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	59,939.00	15,000.00			140,000.00	15,848.00	230,787.00
Kadastra dhe Gjeodezia	60,228.00	13,000.00				25,488.00	98,716.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	41,016.00	13,000.00			1,795,849.00	10,849.00	1,860,714.00
Shëndetësia	966,737.00	200,000.00	40,000.00		95,000.00	119,637.00	1,421,374.00
Administrata	14,541.00					2,922.00	17,463.00
Shërb. kujdesit shëndetësor primar	952,196.00	200,000.00	40,000.00		95,000.00	116,715.00	1,403,911.00
Shërbimet sociale	64,299.00	12,000.00	10,000.00			13,130.00	99,429.00
Kultura, rinia dhe sporti	78,474.00	30,000.00		64,000.00	80,000.00	14,956.00	267,430.00
Arsimi dhe shkenca	4,056,998.00	385,000.00	45,000.00	16,000.00	200,000.00	442,505.00	5,145,503.00
Administrata	43,320.00	98,525.00		16,000.00	200,000.00	16,871.00	374,716.00
Arsimi parashkollor	67,489.00	29,400.00	4,000.00			18,163.00	119,052.00
Shkollimi fillor	3,027,148.00	196,025.00	26,754.00			407,471.00	3,657,398.00
Shkollimi i mesëm	919,041.00	61,050.00	14,246.00				994,337.00
Gjithsej	6,058,699.00	1,120,934.00	180,000.00	200,000.00	2,662,849.00	831,657.00	11,054,139.00

Tabela 8: Shpenzimet komunale të planifikuara sipas kategorive ekonomike dhe programeve – viti 2021

Programet	2021					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbi me	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	97,700.00	36,000.00		144,000.00		277,700.00
Zyra e Kuvendit Komunal	110,000.00	5,000.00				115,000.00
Administrata dhe Personeli	253,000.00	89,500.00			60,000.00	402,500.00
Inspektimet	52,500.00	12,000.00			15,000.00	79,500.00
Buxheti dhe financat	133,000.00	100,735.00	80,000.00		20,000.00	333,735.00
Infrastruktura Publike	17,800.00	170,665.00			115,000.00	303,465.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	120,000	20,000.00	5,000.00			145,000.00
Zyra Komunale për Komunitete	30,600.00	13,000.00				43,600.00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	66,000.00	15,000.00			85,000.00	166,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	66,500.00	13,000.00				79,500.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	45,400.00	13,000.00			2,126,478.00	2,184,878.00
Shëndetësia	1,061,000.00	196,000.00	40,000.00		95,000.00	1,392,000.00
Administrata	16,100.00					16,100.00
Shërb. kujdesit shëndetësor primar	1,044,900.00	196,000.00	40,000.00		95,000.00	1,375,900.00
Shërbimet sociale	71,000.00	12,000.00	10,000.00			93,000.00
Kultura, rinia dhe sporti	86,700.00	31,000.00		45,000.00	60,000.00	222,700.00
Arsimi dhe shkenca	4,462,660.00	384,100.00	45,000.00	16,000.00	165,000.00	5,072,760.00
Administrata	47,800.00	89,500.00		16,000.00	149,788.00	303,088.00
Arsimi parashkollor	78,000.00	30,300.00	4,000.00			112,300.00
Shkollimi fillor	3,302,900.00	201,500.00	26,754.00		15,212.00	3,546,366.00
Shkollimi i mesëm	1,033,960.00	62,800.00	14,246.00			1,111,006.00
Gjithsej	6,673,860.00	1,111,000.00	180,000.00	205,000.00	2,741,478.00	10,911,338.00